



PERPSKTIVAT PËR  
TË ARDHMEN

**FINCOP &  
EDUCOP**

**PUNËTORIA E TETË E  
KOMUNITETIT TË  
PËRBASHKËT TË PRAKTIKËS  
SË EDUKIMIT DHE RAPORTIMIT  
FINANCIAR PULSAR**

14-16 nëntor, 2023  
Vjenë, Austri

# CFRR»

**Centre for Financial  
Reporting Reform**



Qendra për Reformën në Raportim Financiar  
(CFRR), Praktikat e Qeverisjes Globale, Banka  
Botërore

Adresa: Praterstrasse 31, 1020 Vienna, Austria

Faqja në internet: [www.worldbank.org/cfrr](http://www.worldbank.org/cfrr)

Emaili: [cfrr@worldbank.org](mailto:cfrr@worldbank.org)

Telefon: +43-1-217-0700



Programi i kontabilitetit dhe raportimit të  
sektorit publik

Faqja në internet: [www.pulsarprogram.org](http://www.pulsarprogram.org)

## PUNËTORIA E TETË E KOMUNITETIT TË PËRBASHKËT TË PRAKTIKËS SË EDUKIMIT DHE RAPORTIMIT FINANCIAR PULSAR

14-16 nëntor 2023, Vjenë, Austri

### PARATHËNIE

Programi PULSAR, i lansuar në vitin 2017, është një program rajonal dhe në nivel vendi për 13 vende përfituese, në Evropë dhe Azi Qendrore. Objektivi i tij është të mbështesë përmirësimin e kuadrit të kontabilitetit të sektorit publik (KSP) dhe raportimit financiar, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira, për të përmirësuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe performancën e qeverive.

Objektivat dhe qëllimi i Programit PULSAR përcaktohen bashkërisht nga Partnerët PULSAR – Austria, Zvicra dhe Banka Botërore – të cilët gjithashtu ofrojnë mbështetje institucionale për zbatimin e tij dhe mobilizojnë burimet e nevojshme për aktivitetet e tij. Vendet përfituese ndihmojnë në formimin e Programit PULSAR përmes platformave të bashkëpunimit rajonal dhe kontributeve për të dy Komunitetet e Praktikës (CoP): Komunitetin e praktikës së financave (FinCoP) dhe Komunitetin e Praktikës së Edukimit (EduCoP).

Konsolidimi është një nga proceset thelbësore dhe në të njëjtën kohë sfiduese në drejtim të zbatimit të reformave të Kontabilitetit të sektorit publik (KSP). SNKSP 35 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” ofron një udhëzim specifik për konsolidimin, i cili përdor një perspektivë ekonomike që bazohet në konceptin e kontrollit. Megjithatë, konsolidimi në sektorin publik është veçanërisht sfidues duke pasur parasysh organizimin kompleks dhe gamën e gjerë të entiteteve të decentralizuara dhe nën-kombëtare, duke përfshirë Ndërmarrjet me pronësi shoqërore (NSH), të cilat shpesh përdorin kornizë të ndryshme kontabël.

Disa nga sfidat më kritike janë automatizimi i procesit të konsolidimit dhe zhvillimi i mekanizmit të duhur për eliminimin e transaksioneve ndër-institucionale për të siguruar raportimin e vetëm të aktiviteteve ekonomike me palët e jashtme dhe mos përfshirjen e transfertave të brendshme ndërmjet agjencive të ndryshme qeveritare.

Për të trajtuar siç duhet këto sfida, përdorimi i Sistemeve të Informacionit të Menaxhimit Financiar të Integruar (IFMIS) dhe degëve të tij ndërmjet llojeve të ndryshme të njësive të

sektorit publik, bëhet thelbësor për të siguruar që informacioni financiar i përgatitur nga qeveritë është i besueshëm, i përshtatshëm dhe i dobishëm për procesin e vendimmarrjes.

Nga ana tjetër, roli i raportimit të qëndrueshmërisë në sektorët privatë dhe financiarë përmirësohet dhe zhvillimi i standardeve të para të raportimit të qëndrueshmërisë për sektorin publik është i jashtëzakonshëm. Në këtë kontekst, zyrtarët qeveritarë duhet të ndërgjegjësohen dhe të fillojnë të përgatiten për zbatimin e praktikave të raportimit të qëndrueshmërisë në vendet e tyre përkatëse.

Objektivat kryesorë të këtij seminari ballë për ballë do të fokusohen në:

- Diskutim mbi procesin e zbatimit të IFMIS dhe rëndësinë e integritetit ndërmjet buxhetit, kontabilitetit/raportimit financiar dhe statistikave fiskale;
- Diskutim mbi procesin e konsolidimit të pasqyrave financiare të përgatitura sipas kornizave të ndryshme raportuese, duke përfshirë qeveritë vendore dhe Ndërmarrjet Shtetërore (NSH) dhe rolin e IFMIS;
- Diskutim mbi zhvillimet më të fundit në raportimin e qëndrueshmërisë dhe implikimet e tij për sektorin publik për sa i përket legjislacionit, aranzhimeve organizative dhe roleve, lidhjes me raportimin financiar, aspekteve praktike, të tilla si shpalosjet dhe ngritja e kapaciteteve.

**Shënime:**

- Orari i sesioneve bazohet në kohën lokale në Vjenë (CET)
- Përkthimi simultan do të jetë i disponueshëm në shqip, boshnjakisht/kroatisht/serbisht dhe rusisht.

## RENDI I DITËS | DITA E ARRITJES | E HËNË, 13 NËNTOR 2023

19:00 – 21:00 Koktej

## RENDI I DITËS | DITA 1 | E MARTË, 14 NËNTOR 2023

08:30 Regjistrim dhe kafe

### Hyrje

Fjalët hyrëse

- 09:00 **Adrian Fozzard** | Menaxher i Praktikës, Praktika Globale e Qeverisjes, Banka Botërore
- Arman Vatyán** | Menaxher i Programit PULSAR dhe pika fokale e Qeverisjes për Azinë Qendrore, Banka Botërore
- José Rezk** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Drejtues i Ekipit PULSAR EduCoP, Banka Botërore

### Konsolidimi: Nga perspektiva konceptuale dhe makro-fiskale

Ky sesion do të diskutojë rëndësinë e konsolidimit të pasqyrave financiare nga perspektiva konceptuale dhe makro-fiskale

- 09:20 **Ian Carruthers** | Kryetar i Bordit IKSPS
- John Verrinder** | Shef i projektit EKSPS, EUROSTAT [online]
- Sage De Clerck** | Ekonomist i Lartë, Departamenti i Çështjeve Fiskale, FMN
- Moderator:
- Arman Vatyán** | Menaxher i Programit PULSAR dhe pika fokale e Qeverisjes për Azinë Qendrore, Banka Botërore

10:45 Pushim për kafe

## Konsolidimi: Përvojat dhe mësimet e nxjerra nga vendi

Ky sesion do të diskutojë konceptin e konsolidimit të pasqyrave financiare të përgatitura sipas kornizave të ndryshme raportuese, duke përfshirë qeveritë lokale dhe ndërmarrjet publike, nga këndvështrimi i praktikave më të mira dhe përvojave të vendit.

11:15

**Andreas Bergmann** | Profesor i Financave Publike dhe Drejtor i Sektorit Publik në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Cyrihut (ZHAW)

**Giuseppe Grossi** | Dijetar/Profesor Hulumtues i Kontabilitetit i Universitetit Nord (Norvegji); Profesor në Menaxhim Publik dhe Kontabilitet të Universitetit Kristianstad (Suedi)

**Manj Kalar** | Eksperte e IKSPS

**Thomas Müller-Marqués Berger** | Partner dhe Drejtues Global i Kontabilitetit Ndërkombëtar të Sektorit Publik, EY; Kryetar i Grupit Këshillues Konsultativ të IKSPSB

Moderator:

**Jose Rezk** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Udhëheqës i Ekipit të Punës PULSAR EduCoP, Banka Botërore

12:30 Dreka

## Prezantimi i librit “Vlera neto publike: Kontabiliteti, Qeveria dhe Demokracia”

Në këtë sesion do të prezantohen gjetjet kryesore të librit në fjalë

14:00

**Dag Detter** | Themeluesi dhe Partneri Menaxhues Detter & Co

Moderator:

**Arman Vatyan** | Menaxher i Programit PULSAR dhe pika fokale e Qeverisjes për Azinë Qendrore, Banka Botërore

15:00 Pushim për kafe dhe rrjet

## Zbatimi i IFMIS dhe qasja GovTech

15:30

Ky sesion do të diskutojë aspektet kryesore të procesit të zbatimit të IFMIS, integrimin midis buxhetit, kontabilitetit/raportimit financiar dhe statistikave fiskale, si dhe qasjen GovTech për modernizimin e shërbimeve qeveritare.

**Khuram Farooq** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

**Charles Victor Blanco** | Specialist i Lartë i Sektorit Publik, Banka Botërore

**João Ricardo Vasconcelos** | Specialist i Lartë i Qeverisjes, Banka Botërore

Moderator:

**Iwona Warzecha** | Specialiste e Lartë e Menaxhimit Financiar, Bashkëdrejtuese e Ekipit, PULSAR, Banka Botërore

**19:00** Darka në grup

**21:00** Fundi i ditës 1

## RENDI I DITËS | DITA 2 | E MËRKURË, 15 NËNTOR 2023

### Raportimi i Qëndrueshmërisë: Zhvillimet i fundit

Ky sesion do të diskutojë zhvillimet më të fundit në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë dhe implikimet e tij për sektorin publik

**09:00** **Ross Smith** | Drejtor Teknik dhe i Programit, IKSPSB

**Bernhard Schatz** | Menaxher i Lartë, PwC dhe ish-anëtar i IKSPSB

Moderator:

**Arman Vatyán** | Menaxher i Programit PULSAR dhe pika fokale e Qeverisjes për Azinë Qendrore, Banka Botërore

**10:30** Pushim për kafe dhe rrjet

### Raportimi i Qëndrueshmërisë: Prezentim mbi “Karakteristikat e subjekteve të sektorit publik dhe subjektit raportues për raportimin e qëndrueshmërisë”

Në këtë sesion, folësit do të diskutojnë gjetjet kryesore të prezentimit

**11:00** **Andreas Bergmann** | Profesor i Financave Publike dhe Drejtor i Sektorit Publik në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Cyrihut (ZHAW)

**Sung-Jin Park** | Drejtor Ekzekutiv, Qendra e Statistikave të Kontabilitetit dhe Financave të Qeverisë, Instituti i Financave Publike të Koresë (KIPF)

**Dmitri Gourfinkel** | Specialist i Lartë i Qeverisjes, Bashkë drejtues i Ekipit PULSAR FinCoP, Banka Botërore [online]

**12:30 Dreka**

---

**Sesioni 1 i EduCoP: Modelet e edukimit të kontabilitetit në sektorin publik:  
Mësimet e nxjerra dhe përvoja e vendeve të zgjedhura**

---

Prezentim i rezultateve të anketës mbi modelet e edukimit në KSP së bashku me fokusin në rastet specifike të përzgjedhura për certifikimin e KSP, kualifikimin si teknik dhe shembujt e certifikimit të KSP

**14:00**

**Natalia Konovalenko** | Konsulente e Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

**Natalia Ostapiuk** | Konsulente, Banka Botërore

**Erisa Rodhani** | Drejtuese e Kontabilitetit të Sektorit Privat dhe Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri

**Trudy Paul** | Mësimi dhe Zhvillimi i Teknikëve të Kontabilitetit, Instituti i Afrikës së Jugut të Kontabilistëve të Miratuar (SAICA)

**Lefaria Nkm Nsong Kinimi** | ET Konsulent, Banka Botërore

Moderator:

**Jose Rezk** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Udhëheqës i Ekipit PULSAR EduCoP, Banka Botërore

**15:30 Pushim për kafe dhe rrjet**

---

**Sesioni 1 i EduCoP: Fushat e zhvillimit në arsimin KSP: raportimi i  
qëndrueshmërisë dhe sfidat e tjera**

---

Në kuadër të sesionit të dytë të EduCoP, do të diskutohen fushat e reja të edukimit të KSP, duke përfshirë raportimin e qëndrueshmërisë, digjitalizimin dhe sfida të tjera të reja dhe të ardhshme. Përfshin sesionin e pyetjeve dhe përgjigjeve.

**15:30**

**Bruce Vivian** | Drejtor i Arsimit në Kontabilitet, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve

**Ian Murray** | Drejtor, Menaxhimi i Financave Publike, CIPFA

**Will Holt** | Drejtor Menaxhues, Arsimi dhe Trajnimi, Instituti i Kontabilistëve të Miratuar në Angli dhe Uells (ICAEW)

Moderator:

**Natalia Konovalenko** | Konsulente e Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

**17:00 Fundi i ditës së dytë**

---



## RENDI I DITËS | DITA 3 | E ENJTE, 16 NËNTOR 2023

### Diskutimi i programit të punës: Hapat e mëtejshëm

09:00

Diskutim mbi hapat e ardhshëm, duke përfshirë aktivitetet e reja, datat dhe temat për konferencën e ardhshme dhe produktet e njohurive

**Arman Vatyan** | Menaxher i Programit PULSAR dhe pika fokale e Qeverisjes për Azinë Qendrore, Banka Botërore

**José Rezk** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Drejtues i Ekipit PULSAR EduCoP, Banka Botërore

10:30

### Pushim për kafe

### Statusi i vlerësimit të PULSE

11:00

Ky sesion do të prezantojë të rejtat më të fundit mbi kornizën e vlerësimit PULSE si dhe statusin aktual të vlerësimeve pilot të PULSE që po kryhen në Armeni dhe Ukrainë.

**Liudmyla Haponenko** | Shef i Departamentit të Metodologjisë së Kontabilitetit dhe Mbështetjes Rregullatore të Auditimit, Ministria e Financave, Ukrainë

**Karen Alaverdyan** | Shef i Departamentit të Metodologjisë së Kontabilitetit dhe Auditimit, Ministria e Financave, Armeni

**Dmitri Gourfinkel** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Drejtues i Ekipit të PULSAR FinCoP, Banka Botërore [\[online\]](#)

12:00

### Mbyllja e eventit

Fjalët përmbyllëse

**Serdar Yilmaz** | Menaxher Praktik, Financat Publike dhe Prokurimi

**Arman Vatyan** | Menaxher i Programit PULSAR dhe pika fokale e Qeverisjes për Azinë Qendrore, Banka Botërore

**Dmitri Gourfinkel** | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Drejtues i Ekipit të PULSAR FinCoP, Banka Botërore [\[online\]](#)

12:30

### Dreka

14:00

### Fundi i eventit





## PROGRAMI PULSAR

MENAXHOHET NGA


BASHKËFINANCOHET NGA



 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

**CFRR**   
**Centre for Financial  
Reporting Reform**



 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**